



Bashkia e Memaliaj
KESHILLI
2025/5 19.01.2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR

Nr. 05/2 prot.

Gjirokastër, më 13.01.2026

Lënda: Mbi verifikimin e ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut.

KËSHILLIT TË BASHKISË MEMALIAJ
Memaliaj

Në zbatim të ligjit nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut", i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit të ligjshmërisë së akteve të depozituara tek Prefekti i Qarkut, ju konfirmojmë si më poshtë:

1. Vendimi nr. 63, datë 24.12.2025, "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026 (paketa fiskale) Bashkia Memaliaj", është akt me karakter individual. Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut", i ndryshuar, prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve me karakter normativ. Si rrjedhim, verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter individual nuk është kompetencë e prefektit të qarkut.
2. Vendimi nr. 64, datë 24.12.2025, "Për miratimin e buxhetit për vitin 2026", konfirmohet.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI
Albana Hasanaj
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MEMALIAJ
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr 2950/Prot
13

Memorial me 29.12.2025

VENDIM

Nr.64 - Datë 24.12.2025

“PËR MIRATIMIN E BUXHETIT PËR VITIN 2026”

Këshilli i Bashkisë Memorial në mbledhjen e datës 24.12.2025, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë për Projekt – Buxhetin e Bashkisë Memorial për vitin 2026, bazuar në pikën 1 të neneit 41 të ligjit 139 datë 17.12.2015 ‘Për vetëqeverisjen vendore’ nën 4 e 24 të ligjit 9936 datë 26.06.2008 ‘Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë’ ligjit 10296 datë 08.07.2010 ‘Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin’ në kreun VII -të të ligjit 68 datë 27.04.2017 ‘Për financat e vetëqeverisjes vendore’, Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, Shkresa e Ministrisë Financave Nr. 15867 datë 06.11.2025 “Për transferim e pakushtëzuar dhe specifike për vitin 2025.

VENDOSI:

I- Numri maksimal i punonjesve të Bashkisë për vitin 2026

1 Nr i punonjesve sipas struktures 266

Brenda nr të përgjithshme të punonjësve dhe buxhetit të miratuar të kontraktohen me kohë të pjeshme punonjës të kualifikuar (Inxhinier, jurist, teknik ndërtimi marangoz, dezinjator, izolues, saldator, etj) sipas nevojave të Bashkisë dhe Drejtorisë së Shërbimeve publike përgjatë vitit buxhetor 2026.

II- Të miratojë të ardhurat dhe shpenzimet si me poshte. ;

Në (000 lekë)

A - Të ardhura gjithsej	362,091
• Transfertat e pakushtëzuara	187,856
• Transfera pakushtëzuar sektoriale	120,235
• Të ardhura vendore	34,000
• Të ardhura të trashëguara nga viti 2025	20,000
B - Shpenzime gjithsej:	362,091
1. Shpenzime nga transfera e pakushtëzuar	187,857
nga këto:	
a. Për pagat (600)	129,982
b. Për sigurimet shoqërore (601)	22,580
c. Për shpenzime operative (602)	25,395
d. Transfertë korente të brendeshme (604)	6,000
e. Transfera për buxhete familjar e individ (606)	3,900
f. Fond rezervë + kontigjence (609)	
g. Mbrojtja Civile (609)	
h. Shpenzime kapitale (230)	
i. Shpenzime kapitale (231)	
2. Shpenzime nga transfera e pakushtëzuar sektoriale	120,234
nga këto:	
a. Për pagat (600)	87,940
b. Për sigurimet shoqërore (601)	12,362
c. Për shpenzime operative (602)	18,928
d. Transfertë korente të brendeshme (604)	-
e. Transfera për buxhete familjar e individ (606)	-
f. Fond rezerve + kontigjence (609)	-
g. Mbrojtja Civile (609)	-
h. Shpenzime kapitale (230)	-
i. Shpenzime kapitale (231)	1,004
3. Shpenzime nga të ardhurat	54,000
nga këto:	
a. Për pagat (600)	
b. Për sigurimet shoqërore (601)	
c. Për shpenzime operative (602)	3,795
d. Transfertë korente të brendeshme (604)	
e. Transfera për buxhete familjar e individ (606)	
f. Fond rezerve + kontigjence (609)	4,028


g. Mbrojtja civile (609)
h. Shpenzime kapitale (231)

14,084
32,093

III-Drejtoria e Financës autorizohet të bëjë ndarjen e fondeve të miratuara nga Këshilli Bashkiak sipas strukturës buxhetore të miratuar nga Ministria e Financës çdo muaj.

IV-Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55,pika 6 e ligjit nr 139/2015 'Për vetëqeverisjen vendore.' të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë .

Sekretar i këshillit
Erjola Allka



Kryetari i këshillit
Erjon Sinanaj



Vota Pro 9 vota
Vota Kundër 2 vota
Vota Abstenim 2 votë
Zbardhur më datë 29.12.2025